



A K T - T H E M E L I M I

i

SHOQËRIË " G O R A " SH.P.K

M I D I S

1- ENVER BALA , i biri i Fadilit dhe i Zilijes , i dt. 1958 lindur e banues në Fier , lagja " Kongresi i Përmetit " Rruga " Ismet Dertliu " Nr. 7 , madhor , me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar , me letër njoftimi EV Nr . 430495 .

2- LUIZA BALA , e bija e Agos dhe e Inxhis , e dt' 1960 , lindur në Burrel dhe banuese në Fier , adresa e më sipërme , madhore , me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar , me letër njoftimi EV Nr. 430496

Palët ranë dakort të lidhin këtë kontratë me përmbajtje si vijon:

Neni 1

Të krijohet Shoqëria " GORA " SH.P.K me ortakë themelues ENVER GORA dhe LUIZA GORA .

Shoqëria do të ketë formën e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar , së shkurtimisht do të shënohet me inicialet SH.P.K .

Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar në fuqi .

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelimi dhe të statutit të shoqërisë .

Degët e Shoqërisë në rrethe dhe jashtë vendit do të ushtrojnë aktivitetin për llogari të kësaj shoqërie dhe brenda kompetencave të dhëna atyre nëaktin e krijimit .

Neni 2

Shoqëria " Gora " SH.P.K do të ketë Selinë e saj në Qytetin e Fierit , fillimisht në adresën e banesës të ortakëve themelues në Lagjen "Kongresi i Përmetit " , Rr. Ismet Dertliu " Nr. 7 .

Shoqëria mund të hapë edhe vend qëndrime të tjera të dyta , filiale përfaqësi , agjenci në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit .

Neni 3

Shoqëria " Gora " Sh.P.K do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushat :

1- të Projektimit dhe të ndërtimit të objekteve të ndryshëm ndërtimore konformë "i"encës profesionale .

[Handwritten signatures]



2- Në fushën e prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe tregëtimit të tyre .

3- Në fusha të tjera që do të kërkojë nevoja e zhvillimit të kësaj shoqërie .

Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj mbi 10 vjet me aktivitet ekonomik të njëpasnjeshëm .

Neni 5

Kapitali i shoqërisë " GORA " SH.P.K do të jetë 100.000 lekë dhe do të përbëhet nga kuota të barabarta nga 50% secili ortak .

Kapitali i shoqërisë mund të ndryshojë në varësi me vendimin që do të marrin ortakët themelues dhe duke plotësuar të gjitha normat dhe kërkesat e ligjës " Për Shoqëritë Tregtare " .

Neni 6

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj , kapitalin , selinë objektin e veprimtarisë , mënyrën e organizimit , përfaqësimin etj sipas vendimit të Shoqërisë dhe duke u bërë pasqyrimi i saj në Zyrën e Regjistrimit të Regjistrit Tregtar në Gjykatën e Qytetit Tiranë .

Neni 7

Ortakët e shoqërisë kanë të drejta dhe detyrime të barabarta ndaj shoqërisë dhe ligjës .

Ata duhet të bëjnë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë , të ruajnë sekretin dhe të mos dëmtojnë interesat e shoqërisë dhe të ortakut tjetër .

Neni 8

Shoqëria do të drejtohet nga të dy ortakët themelues të shoqërisë të cilët njëkohësisht janë edhe administratorë të saj .

Neni 9

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllën më 31 dhjetor të çdo viti .

Viti i parë kalendarik do të jetë edhe viti ushtrimor i shoqërisë . Po kështu edhe për periudhat e më passhme .

Neni 10

Parapikishtë ortakët themelues nuk bëjnë nderje detyrash kjo edhe



për lidhjen familjare të tyre - si bashkëshortë .

Neni 11

Të ardhurat që do të realizohen nga ushtrimi i aktivitetit të kësaj shoqërie do të ndahen në mënyrë të barabartë midis ortakëve themelues .

Neni 12

Zonja Luiza Bala do të jetë drejtuese teknike e Shoqërisë "GORA SH.P.K , ndërsa ENVER BALA do të jetë drejtuesi ligjor i saj .

NENI 13

1) - Statuti i shoqërisë është pjesë përbërëse e këtij akti themelimi .

Neni 14

Akti i themelimit i përpiluar në disa kopje dheme vlerë të barabartë nënshkruhet prej ortakëve themelues para noterit .

O R T A K Ë T

ENVER BALA

Enver Bala

LUIZA BALA

Luiza Bala

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERIS TIRANË

Nr. 5418 Rep. 694 Kol.

V È R T E T I M

V ë r t e t o h e t s e s o t n ë d a t ë n 29 d h j e t o r 1997 , n ë D h o m ë n e N o t e r i s T i r a n ë , p a r a m e j e n o t e r e s a p a r a q i t ë n p e r s o n a l i s h t E N V E R B A L A d h e L U I Z A B A L A , t ë d y b a n u e s a n ë q y t e t i n e T i r a n e s , m a d h o r ë , m e z o t e s t ë p l o t ë j u r i d i k e d h e p ë r t ë v e p r u a r , t ë v e r i f i k u a r n g a d o k u m e n t a t p e r s o n a l e q ë a t e m b a j n ë , t ë c i l ë t n ë n s h k r u a n p e r e m e j e e k t i n e t h e m e l i m i t t ë S h o q ë r i s ë " G O R A " S H . P . K d h e u n ë n o t e r j a v ë r t e t o j s i p a s l i g j ë s ;

NOTERI



*Pustina
Pustina*



S T A T U T I

I

SHOQËRISË " G O R A " SH.P.K

Në lidhje me aktin e themelimit të Shoqërisë "GORA" SH.P.K, të bazuar në Ligjin 7512 datë 10.8.1991, ligjin 7638 datë 19.11.1992, ortakët themelues të Shoqërisë ENVER BALA dhe LUIZA BALA hartojnë Statutin e Shoqërisë "GORA" SH.P.K me përmbajtje si vijon :

F O R M I M I

Neni 1

Formohet Shoqëria "GORA" SH.P.K e ortakëve themelues :

- 1- ENVER BALA, i biri i Fadilit dhe i Zilijes, i dt. 1958, banues në qytetin e Fierit, në lagjen "Kongresi i Përmetit", Rruga "Ismet Dettliu" Nr. 7, me letër njoftimi EV N. 430495.
- 2- LUIZA BALA, e bija e Agos dhe Inxhis, e dt. 1960, banuese në Fier në adresën e më sipërme, me letër njoftimi EV N. 430496

S E L I A

Neni 2

Selia e Shoqërisë "GORA" SH.P.K do të jetë në qytetin e FIERIT në adresën e banesës të ortakëve themelues, në lagjen "Kongresi i Përmetit", Rruga "Ismet Dettliu" Nr/ 7.

Shoqëria do të ketë edhe vend qëndrimi të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë dhe në miratim të organeve kompetente edhe jashtë shtetit.

K O H Ë - Z G J A T J A


Neni 3

Shoqëria "GORA" SH.P.K do të ketë një kohëzgjatje të veprimtarisë së saj mbi 10 vjet me aktivitet ekonomik të njëpasnjëshëm.

K A P I T A L I

Neni 4

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100.000 lekë dhe do të përbëhet nga kuota të barabarta të dy ortakëve themelues duke patur secili nga 50 % të vlerës tij.



OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i veprimtarie të shoqërisë " GORA " SH.P.K do të jetë për sa vijon :

1- Në fushën e projektimit dhe të ndërtimit të objekteve të ndryshëm ndërtimore - konformë liqencës profesionale .

2- Në fushën e prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe të tregëtimit të tyre .

3- në fusha të tjera që do të kërkojë nevoja e zhvillimit të kësaj shoqërie .

ORGANET DREJTUESË

Neni 6

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

1- Asambleja e shoqërisë (e ortakëve) .

2- Këshilli administrativ .

3- Komisioni i revizionimit .

Fusha e veprimit ,përbërja dhe mënyra e punës të organeve drejtuese , emërimi dhe shkarkimi i antarëve dhe tështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e tyre rregullohen me anën e këtij statuti si dhe me vendime të veçanta që do të marrin ortakët themelues të shoqërisë

Neni 7

Asambleja e Shoqërisë " GORA " SH.P.K përbëhet nga të gjithë ortakët themelues të shoqërisë si dhe ortakët e saj në rast se do të ndryshohet përbërja e tyre .

Asambleja e shoqërisë është organi sovren i shoqërisë .

Themeluesit e shoqërisë drejtojnë atë duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronës private dhe të mjeteve të investuara në shoqëri

Vendimet që merr asambleja bazuar në këtë statut dhe ligjeve fuqi janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë ortakët .

Asambleja thirret sa herë të shikojnë të arsyeshme ortakët p detyrimisht në dhjetor për të miratuar programin e veprimtarisë për vitin e ardhshëm dhe në mars për të miratuar bilancin e vitit të mëparshëm .

Neni 8

Asambleja drejtohet nga administratorët .

Administratori të shoqërisë " GORA " SH.P.K do të jenë; të dy ortakët themelues të Shoqërisë ENVER BALA dhe LUIZA BALA .

Neni 9

Drejtuessa teknike e shoqërisë do të jetë LUIZA BALA - e cila disponon edhe meqencën profesionale si inxhinierë .

Drejtuessa dhe përfaqësuesi ligjor do të jenë për këtë shoqëri të dy ortakët themelues të cilët në mënyrë të pavarur apo edhe veç sejcili prej tyre mund të kryejnë veprime , të nënshkruajnë akte , të kenë të drejtën e kryerjes të veprimeve ekonomike dhe financiare të shoqërisë dhe përfaqësimin të shoqërisë para çdo organi shtetëror , privat dhe gjyqësor

Neni 10

Vendimet e shoqërisë janë të vlefshme kur janë të miratuara nga të dy ortakët .

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban akti i themelimit dhe ky statut si dhe legjislacioni shqiptar në fuqi .

Shoqëria fiton zotësinë juridike me regjistrimin e saj në Regjistrin Regjeter të Gjykatës së "rethit Tiranë , ndërsa ka të drejtën e ushtrimit të aktivitetit ekonomik me marjen e Li'encës nga Organi tatimor kompetent .

Neni 12

Shoqëria do të ketë vulën e saj me përmbajtje të njëjtë me emërtimin e saj " SHOQËRIA GORA SH.P.K " .

Neni 13

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës private dhe marr përsipër të drejta dhe detyrime .

Ajo përgjigjet vetë për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore , brenda kapitalit të saj . themeluesit e shoqërisë përgjigjen për detyrimet personale me kapitalin e tyre personal .

Neni 14

Shoqëria merr vendime , të cilat janë të detyruara për tu zbatuar si nga ortakët ashtu edhe nga të punësuarit në shoqëri .

Neni 15

Asambleja sipas nevojave të shoqërisë mund të emërojë administratorë -rë si dhe të punësojë punonjës të ndryshëm .

Neni 16

Administratorët janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë . Ata mund të kryejnë të gjitha veprimet dhe aktet që do të konsiderohen të arsyeshme për arritjen e qëllimit që ka shoqëria .

Kur këto veprime kryhen nga administratorë të emëruar jo ortakë në shoqëri , këta janë të detyruar të njoftojnë dhe të japin llogari para ortakëve .

MARËDHËNIET E PUNËS

Neni 17

Marëdhëniet e punës në shoqëri do të rregullohen me anën e kontratës së punës që do të lidhet midis kësaj shoqërie si punëdhënëse dhe të punësuarit , konformë Kodit të Punës në fuqi .

Mosmerëveshjet do të zgjidhen nga gjykata kur nuk do të jetë e mundur zgjidhje me mirëkuptim .

Punonjësit merin pagën sipas kontratës dhe nuk merin pjesë në ndarjen e fitimeve që do të realizojë shoqëria në rast se nuk do të jetë parashikuar ndryshe në kontratën e punës .

Neni 18

Administratorët e emëruar - jo ortakë në këtë shoqëri , nuk kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitet konkurues të tjerëdo lloji qoftë për llogari të tyre apo të të tretëve .

Në të kundërtën ata largohen nga puna dhe përgjigjen për dëmet e shkaktuara .

SEKRETI I PUNËS

Neni 19

Të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës . Sekret Sune janë të gjitha materialet dhe aktet të cilat me ligj dhe me vendime të vetë shoqërisë janë shpallur si të till.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit të punës vazhdon edhe pas largimi të tyre nga kjo shoqëri .

Neni 20

Shoqëria për rregullimin e marëdhënieve me të punësuarit mund të hartojë rregullore pune .

PËRFAQËSIMI

"eni 21

E drejta e përfaqësimit të shoqërisë ju takon në dy pronarëve të saj të cilët njëkohësisht janë edhe administratorë . "jo e drejtë mund të ushtrohet edhe nga persona të tjerë të emëruar nga kjo shoqëri të cilët veprojnë brenda kompetencave të dhëna atyre me aktin e emëruar apo me proces verbale të veçanta .

Pronarët - administratorë përfaqësojnë shoqërinë para çdo organi shtetëror , privat dhe gjyqësor .

BILANCI DHE TË ARDHURAT

"eni 22

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllan më 31 dhjetor të çdo viti përveç kur vendos ndryshe shoqëria . Vit ushtrimor do të qubet viti kalendarik .

Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatit ekonomik FITIME - HUMBJE , bazuar në ligje dhe rregulla të mbajtjes të kontabilitetit nga pjesitë ekonomike private . e miratimin e bilancit shoqëria vendos edhe për krijimin e fondeve të ndryshëm si fondin rezervë etj .

"eni 23

Të ardhurat neto do të ndahen në mënyrë të barabartë midis ortakëve .

SHPËRBERJA E SHOQËRISË

"eni 24

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë do shkakut si humbje e kapitalit të shoqërisë , pamundësi veprimi etj .

Asambleja e shoqërisë vendos për mënyrën e likuidimit dhe cakton likuidatorë , të cilët janë përgjegjës deri në shpërbërjen e plotë të shoqërisë .

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

"eni 25

Përse nuk është shprehur plotësisht në aktin e themelimit dhe në statut shoqërie do të referohet në legjislicionin në fuqi si



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



dhe posedrisht në Ligjën " Mbi shoqëritë Tregëtare " dhe Kodin
 Ndryshimi i legjislacionit do të pasqylojë edhe ndryshimin
 e këtyre akteve për t'u përshtatur kërkesave të tij .

Ndryshimet e plotësimet do të ndjekin të njëjtën procedurë
 siç është krijuar kjo shoqëri dhe do të pasqyrohen në regjistrin
 tregëtar të Gjykatës së "rethit Tiranë .

Neni 26

Statuti i hatuar me vullnetin e lirë të ortakëve themelues
 nënshkruhet prej tyre regullisht para noterit .

O R T A K Ë T

ENVER BALA

Enver Bala

LOUIZA BALA

Luiza Bala

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
 DHOMA E NOTERIS TIRANË

Nr. 5418 "no. 694" Kol.

V E R T E T I M

Vërtetohet se sot në datën 29 dhjetor 1997 , në Dhomën e Noteris
 Tiranë , para meje Noterës u paraqitën personalisht Enver Bala dhe
 Luiza Bala , të dy me dorë , me zotësi të plotë juridike , me identitet
 si të shënuar në këtë akt , të verifikuar nga letër njoftimit që
 ata mbajnë me Nr. KV Nr. 430495 dhe 430496 të cilët nënshkruan para
 meje Statutin e "shoqërisë " GORA " SH.P.K dhe unë Noterja vërtetoj
 sipas ligjës .

NOTERË
Sistere Pu
lesh

